



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 41/2 Prot.

Tiranë, më 21/3/2011

Lënda: Rekomandim për **“Conad Shqipëria” sh.p.k.**

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **“Conad Shqipëria” sh.p.k.**,

KONSTATOVA

Më datë 20.12.2010, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **“Conad Shqipëria” sh.p.k.** me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kritereve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “Conad Shqipëria” sh.p.k është shoqëri tregtare pjesë e rrjetit të supermarketeve “Conad Adriatico” (me qendër në Itali), i cili gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe për kategorinë, *klientë*.

Grupi më i madh i kësaj kategorie përfaqëson klientët me **“kartën Conad”**.

Të dhënat personale për këtë grup klientësh mblidhen nëpërmjet formularit të pranimit “kartë anëtarësie” i cili është hartuar nga kontrolluesi dhe i shpërndarë nëpër pikat e rrjetit supermarketeve “Conad Shqipëria”.

Formulari i pranimit i ofrohet klientit pranë supermarketeve “Conad” të cilët me vullnetin e tyre pranojnë ose jo pajisjen me kartë anëtarësimi.

Formulari i pranimit nga ana e kontrolluesit “Conad Shqipëria” sh.p.k, është konceptuar në dy pjesë:

- Në pjesën e **parë** të tij, mblidhen **të dhënat e kërkuesit** me qëllim pajisjen me “kartë anëtarësie” të dhëna personale si; emri, mbiemri, datëlindja, seksi, adresa, telefoni cel dhe fiks, e-mail, mbiemri i bashkëshortit, numri i pjesëtareve të familjes, numri i pjesëtareve të familjes që kryejnë blerje.

Nga analiza që ju bë kategorisë së të dhënave personale që kontrolluesi mbledh, për pajisjen me “kartë anëtarësie” të klientëve, parë kjo në raport me kushtet dhe kriteret e nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, rezulton se janë të mjaftueshme dhe nuk e tejkalojnë qëllimin për të cilën ato mblidhen dhe përpunohen, por konsideron të tepërt dhe jo në përputhje me qëllimin mbledhjen e të dhënës personale që lidhet me mbiemrin e bashkëshortit. Përfaqësuesja e kontrolluesit deklaroi se mbledhja e kësaj të dhëne është sipas formularit që përdoret nga kompania mëmë “Conad Adriatica” në Itali, ku përdorimi i dy mbiemrave është një fenomen i zakonshëm dhe për të verifikuar nëse brenda së njëjtës familje ka dhe pjesëtarë të tjerë të pajisur me kartën “Conad”. Nisur nga fakti që në Shqipëri ky fenomen (përdorimi i dy mbiemrave) nuk është i përhapur mendojmë se mbledhja e të dhënës personale “mbiemri i bashkëshortit” prek privatësinë e këtij të fundit dhe kjo e dhënë mund të deklarohet vetëm nga ai, kjo dhe për faktin se mbledhja e të dhënave personale nëpërmjet formularit ka për qëllim pajisjen e personit aplikant me kartën “Conad”.

-Në pjesën e **dytë** mblidhen **të dhënat të përgjithshme për aplikantin dhe familjen e tij** me qëllim pranimit e iniciativave publicitare për të dhe familjen e tij si; datëlindja e bashkëshortit/bashkëshortes dhe fëmijve, profesioni i tyre dhe arsimit, hobet.

Kontrolluesi “Conad Shqipëria” sh.p.k, në këtë “formular pranimi” informon klientin mbështetur në nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” se: ... “Të dhënat personale të treguara nga ju në këtë pyetësor do të përfshihen

në arkivën elektronike të Conad Adriatico Soc.Coop.a.r.l. dhe të pikave të shitjes ku do të përdoret karta.

Të dhënat personale mblidhen për të bërë të mundur realizimin e insiativave publicitare të posaçme për mbajtësit e kartës së anëtarësimit si dhe për tju informuar në kohë edhe me anë të mjeteve të komunikimit elektronik si posta elektronike , mesazhe sms, mbi të gjitha mundësitë dhe avantazhet që lidhen me përdorimin e kartës. Dhënia e informacioneve nga ana juaj nuk është e detyrueshme por është e domosdoshme për realizimin e iniciativave tona publicitare. Veprimet për përpunimin e të dhënave do të kryhen nga puno njësit dhe bashkëpunëtorët tanë të quajtur përgjegjësit e përpunimit.

Përpunimi mund të kryhet edhe nëpërmjet përpunuesve të jashtëm që veprojnë në bashkëpunim me Conad Adriatico Soc.Coop.a.r.l. ju mund të shtoni në çdo moment të drejtat e parashikuara nga kreu IV i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë të veçantë të njiheni me të dhënat tuaja personale, të kërkonti korrigjimin ose fshirjen si dhe të kundërshtoni përdorimin e tyre me anë të një letre drejtuar Përgjegjësit të të Dhënave Personale të Conad Adriatico Soc.Coop.a.r.l..... ose Përgjegjësit të të Dhënave Personale që ka lëshuar kartën. Këtyre personave mund tu kërkohet gjithashtu një listë e përditësuar e personave të tjerë përgjegjës të përpunimit të të dhënave nëse ka të tillë”

Në formular shprehet në mënyrë të qartë mënyra e dhënies së pëlqimit të klientit veçmas për të dy qëllimet e mbledhjes së të dhënave personale të tij.

Marrja e pëlqimit të klientëve për të dy qëllimet bëhet duke nënshkruar për secilin qëllim veçmas në fund të faqes së dytë të formularit të pranimit pas mbledhjes së të dhënave. “Formulari i pranimit” i formatuar në këtë mënyrë vështirëson nënshkrimin për çdo qëllim specifik të shprehur, sipas nenit 5 pika b) dhe c) të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Kontrolluesi “Conad Shqipëria” sh.p.k përdor sistemin e video survejimit (CCTV) duke mbledhur dhe përpunuar në serverët e tij të dhëna personale të subjekteve të të dhënave nëpërmjet regjistrimit të imazheve etj. Pozicionet dhe këndet e vendosura të këtyre kamerave janë në funksion të qëllimit të kontrolluesit (sigurinë) dhe nuk u konstatuan raste të shkeljeve për sa i përket vendosjes së këtyre kamerave në ambiente të tilla si (zyra , dhoma zhveshje, banja etj).

U konstatua se, kontrolluesi mban të dhënat e mbledhura nga CCTV për një periudhë të përcaktuar në funksion të qëllimit (7 ditë), të drejtë aksesit mbi këto të dhëna kishte vetëm punonjësi përgjegjës i sigurisë së kompanisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë.

Në serverin qendror të kontrolluesit në të cilin ka akses punonjësi i sigurisë së kompanisë “Conad Shqipëria” (specialist i logjistikës), në raste të veçanta të verifikimeve për situata të ndryshme (kthim mbrapa të imazheve në kohë) bashkëpunohet me përfaqësues të firmës “Pelikan” me të cilin kontrolluesi ka lidhur kontratë sipërmarrje “Për shërbimin e ruajtjes së objektit Conad Shqipëria”. Punonjësit të shërbimit të rojës së firmës “Pelikan”, kontrolluesi “Conad Shqipëria” i ka dhënë të drejtën e vëzhgimit në kohë reale në një monitor, pamjet që

mblidhen nga kamerat e vendosura në të gjithë ambientet e kontrolluesit, pa të drejtën e ndërhyrjes në këtë sistem.

Kontrolluesi ka informuar për përdorimin e sistemit të videosurvejimit, nëpërmjet vendosjes së tabelave paralajmëruese në vende të dukshme.

Në kontratën që kontrolluesi “Conad Shqipëria” ka lidhur me shoqërinë e sigurisë fizike “Pelikan” nuk janë parashikuar të drejtat dhe niveli i aksesit të palëve lidhur me përdorimin e sistemit të videosurvejimit (CCTV)-ve, sipas nenit 27/2 germa ‘ç’, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të nenit 5, pika b) dhe c) të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “Conad Shqipëria” sh.p.k. duhet të kryejë realizimin në një formë tjetër të “formularit të pranimit” për kartën e anëtarësisë “Conad” ku:
 - a) Në “formularin e pranimit” të shkruhet emri “Conad Shqipëria” si kontrollues i të dhënave personale që mblidhen nëpërmjet këtij formulari.
 - b) Mbledhja e të dhënave personale me qëllim pajisjen me kartë anëtarësie “Conad” dhe nënshkrimi për këtë qëllim të jetë në vazhdimësi dhe në njërin anë të formularit.
 - c) Të mos mbledhë të dhënën personale që lidhet me “mbiemrin e bashkëshortit” me qëllim pajisjen me kartë anëtarësie “Conad” për aplikantin.
 - d) Mbledhja e të dhënave personale me karakter të përgjithshëm për aplikuesin dhe familjarët e tij me qëllim dërgimin e materialeve informuese, publicitare dhe promocionale dhe nënshkrimi për këtë qëllim të jetë në vazhdimësi dhe në anën e pasme të formularit.
- 2) Në zbatim të nenit nenit 27/2, germa”ç”, kontrolluesi “Conad Shqipëria” sh.p.k. duhet të përcaktojë në një dokument ligjor, ose në kontratën sipërmarrëse lidhur me shoqërinë e ruajtjes dhe të sigurisë fizike “Pelican Security” sh.p.k të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me aksesin dhe personat e autorizuar në të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të video survejimit.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Në rast moszbatimi të këtyre rekomandimeve, Komisioneri verpon sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen ne Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

